

SHOQERIA TREGTARE
Me pergjegjesi të kufizuar

"ALTECH GROUP" shpk.
TIRANE

AKT THEMELIMI

Ne TIRANE, sot me daten 12/05/2023 une i nenshkruari :

1-Muhamed Veliu, datelindja 02.04.1991, lindur ne Maqedoni dhe banues ne Maqedoni, madhor ,me zotesi te plote per te vepruar,identifikuar me nr ID 0204991473011

Me Vullnet të lire të plote , dhe iniciativen e lire private, mbeshtetur :
Ne Kushtetuten e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil ne fuqi,
Ne baze te Ligjit nr. 9901 datë 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe shoqëritë tregëtare" dhe Ligji nr. 9723 date 03.05.2007 me ndryshimet " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit "
krijojme shoqerine tregtare, me pergjegjesi të kufizuar,
" ALTECH GROUP" shpk TIRANE, Shqiperi.

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga Ortaku I sipercituar, me emrin " ALTECH GROUP" shpk Tirane, emertimi i të cilit do të jete i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia e shoqerise " ALTECH GROUP" shpk eshte :
Tirane,rruga e Kavajes,qendra Condor,kati 3,njesia nr 7.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithë juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashte shtetit.
Me vendim të Asamblese se ortakeve, mund të krijohen ose anulohen , seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashte saj.
Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashte shtetit krijohen kur nje gje të tille parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtes nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njqintmije) leke , formuar dhe nenshkuar nga ortaku i vetem , vlere e cila do te shlyhet mbasi shoqeria te jete rregjistruar ne QKR dhe i perket ortakut te vetem :

Z. Muhamed Veliu, zoterues i nje kuote me vlere 100 000(njqind mije) lek,qe perben 100% te kapitalit themeltar

Shoqeria pergjigjet per humbjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte mbi 10 vjet.
Me vendim të Asamblese se Ortakeve, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim QKR per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtar.

NENI 6

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të plote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 7

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil.

Ortaket, kane të drejte të transferojne jashte territorit të Republikes se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e tyre perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Noterial dhe per nje gje të tille Asambleja e Ortakeve duhet të marre paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo t'u behen të ditura.

NENI 8

Objekti i veprimtarise:

Import ,tregti ,marketing I pajisjeve elektroshtepiake dhe pajisjeve elektrike.Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter biznesi I cili nuk eshte I ndaluar nga ligji I zbatueshem ne republiken e Shqiperise



NENI 9

Me vendim të Asamblesesë Ortakeve, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtime të tjera të cilat janë me interes për mbarevajtjen e shoqërisë.

NENI 10

Me vendim të Asamblesë së Ortakeve, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjerë, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 11

Asambleja e Ortakeve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjitha kompetencat që ligji "Për Tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i njeh asamblesës së ortakëve. Asambleja e Ortakeve mund t'ia delegoj kompetencat një ose më shumë administratorëve të caktuar prej saj ose dhe një personi fizik jashtë ortakërisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokures.

NENI 12

Administrator i shoqërisë "ALTECH GROUP" shpk, është
**1- Shkëlzen Aliu, datelindja 03.09.1985, lindur dhe banues në Tiranë,
madhor, me zotësi të plotë për të vepruar, identifikuar me nr ID I50903067P**

I Cili është i zgjedhur në këtë pozicion për një periudhë jo më shumë se pesë vjet.

NENI 13

Ky akt themelimi u redaktua në 4 kopje, të cilat nënshkruhen prej ortakut në çdo faqe.

THEMELUESIT E SHOQËRISË TREGTARE

"ALTECH GROUP" SHPK
Muhamed Veliu

